

**SENATI AKADEMIK**

Nr. 128 prot.

Tiranë, më 09.02.2023

**VENDIM**

**“Për kriteret e pranimit në Universitetin “Metropolitan Tirana“, për vitin akademik 2024-2025“**

Bazuar në Ligjin Nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë“ dhe në Statutin e Rregulloren e Brendshme të Universitetit “Metropolitan Tirana“, Senati Akademik, në mbledhjen e radhës, bazuar në diskutimet e zhvilluara sipas rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e Krihereve të Pranimit, si më poshtë:

**1. Për programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë:**

a. Nota mesatare e shkollës së mesme, sipas përcaktimit në VKM përkatëse.

b. Për programet e studimit në gjuhë të huaj, kandidatët duhet të zotërojnë dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj sipas udhëzimit në fuqi të MASR.

**Për programet e studimit me karakter profesional 2 vjeçar:**

a. Sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

**2. Për programet e ciklit të dytë**

a. Kandidatët duhet të zotërojnë të paktën një program studimi të ciklit të parë, sipas specifikave të programit të studimit.

b. Kandidatët duhet të zotërojnë dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj sipas udhëzimit në fuqi të MASR.

c. Do të kenë përparësi Kandidatët që kanë notën mesatare të studimeve të ciklit të parë mbi 6.

d. Për programet e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike dhe Master i Shkencave në Software Engineering (në gjuhën angleze), do të kenë përparësi Kandidatët që kanë notën mesatare të studimeve të ciklit të parë mbi 7.



**UNIVERSITETI®  
METROPOLITAN  
TIRANA**

e. Për programet e studimit të ciklit të dytë, raste të veçanta që nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare së ciklit të parë, në rast se do të ketë kuota të lira, do të shqyrtohen nga një komision i posaçëm.

3. Për programet e ciklit të tretë

a. Kandidatët duhet të zotërojnë të paktën një program studimi të ciklit të parë dhe të dytë, sipas specifikave të programit të studimit.

b. Kandidatët duhet të zotërojnë dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj sipas udhëzimit në fuqi të MASR.

c. Do të kenë përparësi Kandidatët që kanë notën mesatare të studimeve të ciklit të parë mbi 8.5.

II. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2024-2025.

III. Ky vendim i përcillet MAS, QSHA dhe portalit Ualbania, dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Universitetit „Metropolitan Tirana“.

**Kryetar i Senatit Akademik**

**Rektori**

**Prof. Dr. Nikolla Civici**

